




REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI
PEDAGOGJIK
I KOSOVES

INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUTE

Në bazë të nenit 23 të Ligjit nr.04/L-135 për Veprimtarinë Kërkimore-Shkencore (11/02 maj 2013), nenit 33 të Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës (11.06.2024), Këshilli Drejtues i Institutit Pedagogjik të Kosovës (IPK), në mbledhjen e mbajtur më dt. 12.09.2024 miratoi këtë:

RREGULLORE E HONORAREVE TË AUTORËVE DHE TË PUNËVE TË TJERA ME HONORAR PËR VEPRIMTARINË BOTUESE

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohet mënyra, shuma dhe kushtet e pagesës së honorareve për personat e angazhuar në Veprimtarinë botuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës (tani e tutje IPK).

Neni 2 Pagesat për përgatitjen revistës shkencore “Kërkime Pedagogjike”

Pagesa e honorareve për revistën shkencore “Kërkime Pedagogjike” bëhet për tabak autori (T/A)

1. Kryeredaktori ----- 20 euro për T/A
2. Anëtarët e redaksisë..... 15 euro për T/A
3. Përgatitja teknike (faqosje) 10 euro për T/A
4. Redaktim gjuhësore për të angazhuar- 10 euro për T/A
5. Korrektura (Lektura) 10 euro për T/A
6. Recensionet 10 euro për T/A

Neni 3
Pagesa e anëtarëve të Këshillit Botues të revistës

1. Anëtarët e Këshillit Botues paguhen në shumën 100 € bruto për një numër publikimi.

Neni 4
Pagesa e punëve për përgatitjen e botimeve të veçanta me mbi normë

1. Për botimin e parë të punimit që botohet nga Instituti, honorari paguhet për tabak autori, ku 1 tabak autori i ka 16 faqe tekst A4 (tani e tutje T/A) si vijon:

1.1 Kryeredaktori.....	20euro
1.2 Redaktori shkencor.....	15euro
1.3 Recensentët për botime monografi.....	15euro
1.4 Recensentët për botime jo monografi.....	10euro
1.5 Përgatitja teknike (faqosje)	10 euro
1.6 Redaktim gjuhësor.. ..	10 euro
1.7 Korrektura (Lektura)	10 euro

2. Në rast të ribotimit të punimeve nuk paguhet honorar.

Neni 5
Pagesa e autorit për botim mbi normë (T/A)

Honoraret autorët për punën jashtë normës së planifikuar bëhet atëherë kur nga ai /ajo kërkohet hulumtim ose përgatitje tjetër profesionale për nevoja të IPK-së, ose institucioneve të tjera për të mirën publike, ose të sistemit arsimor në veçanti.

1.1 Honorari i autorit për punimin shkencor	100 € (T/A)
1.2 Honorari i autorit për monografi	100€ (T/A)
1.3 Honorari i autorit për punim jo monografi.....	80€ (T/A)

Neni 6
Pagesa për organizim të konferencave dhe të aktiviteteve tjera shkencore

- 1.1 Anëtarët e Këshillit organizues të konferencave, të simpoziumeve apo të aktiviteteve tjera shkencore.....100€.
- 1.2 Anëtarët e Këshillit editorial të konferencave apo të aktiviteteve tjera shkencore ... 150€.

Neni 7
Pagesat për angazhimet tjera në projekte

1. Angazhimi në projekte shkencore:

- 1.1. Hulumtuesit/punëtorët shkencorë të brendshëm, të angazhuar në projekte shkencore brenda territorit të Republikës së Kosovës me vetura private do të kompensohen në bazë të kilometrave dhe me çmim të kontratave publike për furnizim me derivate.
- 1.2. Hulumtuesve-punëtorëve shkencorë të brendshëm dhe të jashtëm të angazhuar në projekte shkencore brenda e jashtë territorit të Republikës së Kosovës u paguhen shpenzimet e akomodimit e të hulumtimit si dhe mëditjet në bazë të legjislacionit në fuqi.

Neni 8
Obligimet e tatimit në burim

1. Për të gjitha honoraret që realizohen në bazë të kësaj Rregulloreje është e obligueshme pagesa e tatimit në burim sipas shkallës që zbatohet në Kosovë.

Neni 9
II. Dispozitat përfundimtare

1. Kjo rregullore hyn në fuqi 7 (shtatë) ditë pas miratimit dhe nënshkrimit të saj nga Kryesuesi i Këshillit Drejtues të Institutit.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet rregullorja për veprimtarinë botuese të Institutit Pedagogjik të Kosovës, Nr. 449 të datës 30.12.2022.
3. Plotësimet dhe ndryshimet e kësaj rregullore bëhen me procedurë të njëjtë, e cila vlen për miratimin e saj.

Datë: 12.09.2024, Prishtinë

Kryesues i Këshillit Drejtues



Zvzd. Ismet Pofera